

11–14  
 JUNE 2025  
 PARIS

**VIVA**  
**TECHNOLOGY**
**EUROPE'S BIGGEST STARTUP AND TECH EVENT**

## SHQIPËRIA PJESËMARRËSE NË VIVATECH 2025

Për herë të parë, AIDA ishte pjesë e VivaTech 2025 në kuadër të fushatës së saj të outreach për sektorin ICT/BPO, në stendën "Albania Future Now", të kryesuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Shqipëria u prezantua si një destinacion premtues për shërbimet teknologjike dhe inovacionin me një vizion të qartë dhe me një ofertë konkrete për investitorët, partnerët dhe sipërmarrësit.

Delegacioni shqiptar zhvilloi dhjetra takime intensive me liderë të teknologjisë dhe partnerë potencialë, të intriguar nga mundësitë që ofron Shqipëria në sektorin ICT/BPO.

Prezenca e Ministrit, z. Blendi Gonxhja, i cili zhvilloi takime strategjike, konfirmoi përpjekjet serioze për ta vendosur Shqipërinë si një qendër inovacioni në Europë.

Fushata outreach, e zhvilluar nga AIDA, rezultoi mjaft e suksesshme, me interes konkret nga kompani dhe investitorë, duke vendosur themelet për bashkëpunime të reja në sektorin ICT/BPO.

Me guxim, kreativitet dhe vizion të qartë, prezantuar potencialin në rritje të Shqipërisë dhe një brez të ri që guxon të ëndërrojë më shumë.



**Shqipëria përmbyll me sukses pjesëmarrjen në VivaTech 2025!**

VivaTech përfundon, por fushata outreach vazhdon. Koha për të investuar në Shqipëri është tani!



## EXPORT ALBANIA - NJË MUNDËSI MË SHUMË PËR EKSPORTIN, NË DORËN TUAJ

Kompass Easy Business është moduli profesional i platformës Kompass, i cili ofron akses në mbi 50 milionë kompani në më shumë se 70 vende. Ai bazohet në një sistem klasifikimi të produkteve dhe shërbimeve me mbi 53,000 kode specifike, dhe ofron mundësi të gjera filtrimi dhe analizimi të kompanive dhe tregjeve duke përdorur një tipologji unike.

Sistemi identifikon automatikisht partnerë të përshtatshëm për biznesin tuaj. Ofrojmë lidhje direkte duke organizuar takime B2B online apo fizike në ekspozita ndërkombëtare, ku ju prezantoni produktet tuaja përpara blerësve nga Evropa, Azia, ose Amerika. Ofrojmë asistencë gjatë negociatave, përgatitjes së dokumentacionit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve.

### Funksionalitetet kryesore:

- ✓ Kërkim i avancuar sipas vendit, sektorit, madhësisë së kompanisë, kontakteve, qarkullimit etj.
- ✓ Profile të detajuara të kompanive me informacione të verifikuara.
- ✓ Filtrim sipas rolit: Prodhuës, Distributor, Eksportues, Importues.
- ✓ Eksport në PDF dhe Excel/CSV të rezultateve të kërkuara.
- ✓ Dërgesë direkte email-esh kontakteve ekzekutive.
- ✓ Ruajtje dhe shpërndarje e kërimeve.
- ✓ Analiza të dhënash për tregje, sektorë apo vende të synuara.
- ✓ Shtim shënimesh personale për kompani të caktuara.

### Si të përfitoj?


- ✓ Hyni në [www.exportalbania.al](http://www.exportalbania.al) dhe regjistrohuni si kompani.
- ✓ Aktivizoni aksesin tuaj për EasyBusiness.
- ✓ Shikoni videot tutoriale të publikuara në faqe për përdorim efikas.
- ✓ Filloni kërkimet tuaja për klientë, partnerë dhe tregje të reja.

### Video online:

<https://www.youtube.com/playlist?list=PLRoz0Ez57xtGh29TfeUye5XYepCd3819Q>



**Ky instrument strategjik do ju ndihmojë si të gjeni klientë, si të filtroni tregjet dhe si të eksportoni rezultatet!**  
**Bashkohuni me platformën dhe bëhuni pjesë e tregut global!**



## Fushata outreach për sektorin ICT/BPO

Kjo fushatë synon të ndërtojë narrativën e Shqipërisë si një destinacion të besueshëm dhe fitimprurës për ICT-BPO, duke kombinuar të dhëna konkrete, dëshmi, dhe një rrugë të qartë për bashkëpunim me AIDA-n.

Gjatë muajit Qershor AIDA realizoi takime dhe evente duke identifikuar nevojat konkrete të kompanive të mëdha dhe të nxisë bashkëpunimin për përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit në këtë sektor strategjik.

Shqipëria është shndërruar në një destinacion kryesor për shërbimet ICT-BPO me kulturën e saj urbane, disponueshmërinë e burimeve, infrastrukturën dhe incentivat tërheqëse për investimet. Tirana është qendra kryesore e ICT-BPO-së në Shqipëri, e ndjekur nga Durrësi, Shkodra dhe Vlora. Sektori ICT-BPO në Shqipëri ka parë rritje të qëndrueshme që nga fillimi i tij, duke rritur punësimin dhe duke arritur vlera të industrisë që tejkalon 130 Milionë dollarë. Në T4 2024, ky sektor u rrit me 6.33% krahasuar me tremujorin e mëparshëm – një nga kontribuuesit kryesorë në ekonominë shqiptare.

Me talent të ri, shumëgjuhësh dhe kosto konkurruese, vendi ofron një terren të artë për investime në teknologji dhe shërbime.

- ✓ 40–60% më lirë se në Perëndim
- ✓ Fuqi punëtore e aftë dhe teknologjike
- ✓ Pozicion ideal për tregjet europiane
- ✓ Në kohezion me BE

**Investo tani** – Shqipëria nuk është vetëm një destinacion outsourcing-u, por partneri yt për rritje globale!



## Memorandum Bashkëpunimi mes AIDA dhe DPT

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) nënshkruajnë një memorandum bashkëpunimi me synim forcimin e shkëmbimit institucional të të dhënave dhe rritjen e efikasitetit në monitorimin e zhvillimeve ekonomike.

Bashkëpunimi synon të përmirësojë koordinimin ndërmjet dy institucioneve në mbështetje të politikave zhvillimore dhe të klimës së investimeve në Shqipëri.

Ky hap përforcon angazhimin e përbashkët për transparencë, bashkërendim dhe mbështetje më të mirë për sektorët prioritarë të ekonomisë.



## AIDA zhvillon takim me Agjencinë Franceze për Zhvillim (AFD)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), zhvilloi një takim zyrtar me përfaqësuesit e Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD), në kuadër të misionit të tyre për analizën makroekonomike dhe vlerësimin e klimës së investimeve në Shqipëri.

Diskutimi u fokusua në klimën aktuale të të bërit biznes në Shqipëri, zhvillimet në politikat për tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe interesin e investitorëve për potencialin që ofron Shqipëria.

AIDA informoi përfaqësuesit e AFD mbi incentivat kryesore sipas sektorëve të ekonomisë, ndryshimet dhe trendet e vërejtura si përsa i takon shteteve dhe sektorëve të interesit nga ana e investitorëve të huaj, si dhe rolin e Agjencisë si një urë lidhëse mes investitorëve dhe institucioneve publike, përmes ofrimit të shërbimeve të asistencës aftercare.



## AIDA merr pjesë në tryezën e rrumbullakët të projektit RegioTrade

Gjatë datave 12 - 13 Qershor, AIDA mori pjesë në Grupin e Përbashkët të Punës për Investime dhe në tryezën e rrumbullakët të projektit RegioTrade, si pjesë e angazhimit për avancimin e bashkëpunimit rajonal dhe të klimës së investimeve në Ballkanin Perëndimor. Nën organizimin e RCC me mbështetjen e Komisionit Evropian, Bankës Botërore dhe GIZ, u diskutuan:

- ◆ Rekomandimet për investime të huaja direkte të qëndrueshme.
- ◆ Parimet e përbashkëta për lehtësimin e investimeve në WB6.
- ◆ Krijimi i një klime të qëndrueshme për investime të gjelbra.

Tryeza e projektit RegioTrade vuri theksin mbi bashkëpunimin rajonal për të promovuar investime të qëndrueshme dhe për të adresuar sfidat në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me investitorët. AIDA mbetet e angazhuar për të forcuar mekanizmat që nxisin një klimë sa më të favorshme për investitorët në Shqipëri dhe në rajon.



## AIDA organizon takimet informuese “Info Day” në disa qytete

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), gjatë muajit Qershor vijoi me takimet informuese dedikuar bizneseve të Qarkut Berat, Durrës dhe Elbasan, me qëllim prezantimin e “Platformës së Re Kombëtare të Eksportit”. Qëllimi kryesor është informimi i drejtpërdrejtë mbi platformën e re të eksporteve si dhe mundësitë konkrete që ofron rrjeti EEN (Enterprise Europe Network).

Kjo platformë është krijuar për të ndihmuar bizneset shqiptare:

- Të zgjerojnë tregjet dhe mundësitë për tu rritur përtej kufijve.
- Të krijojnë mundësi partneritetesh ndërkombëtare,
- Mbështetje për rritje konkurruese,
- Promovim në rrjete të gjera biznesi në Europë.

Platforma është një instrument inovativ që synon të mbështesë ndërmarrjet shqiptare në rritjen e kapaciteteve eksportuese dhe ndërkombëtarizimin e tyre. Gjatë këtyre takimeve u prezantua struktura e platformës, shërbimet që ajo ofron, mënyra e përdorimit dhe përfitimet për bizneset. Ditë të tjera informuese do të vijojnë në qarqe të ndryshme të vendit.



## Drejtoresha Ekzekutive Znj. Laura Saro pret në takim Ambasadorin e Republikës së Kosovës

Drejtoresha e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), znj. Laura Saro, mirëpriti në një takim zyrtar Ambasadorin e Republikës së Kosovës, z. Skënder Dyrmishi.

Gjatë takimit, palët dakordësuan bashkëpunimin në të ardhmen duke theksuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve.

Diskutimet u përqendruan në zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe për të tërhequr dhe sjellë investime të reja, si edhe organizimin e takimeve me axhenda të përbashkëta.



## AIDA - Takim me delegacionin e investorëve Italian

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), mirëpriti një delegacion investorësh italianë të interesuar për t'u njohur me mundësitë e investimeve në Shqipëri. Delegacioni shoqërohej nga z. Stefano Salmaso, Konsull i Tregtisë pranë Ambasadës Italiane në Tiranë.

Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA, i prezantoi investorëve klimën e favorshme për investime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, projektet potenciale në zhvillim, si dhe mbështetjen që AIDA ofron për investorët e huaj. Delegacioni italian shprehu interes të veçantë për mundësitë që ofron Shqipëria si një destinacion në rritje për turizmin cilësor dhe të qëndrueshëm dhe jo vetëm. Kompanitë prezente shprehën gatishmërinë të ndajnë informacionet mbi mundësitë që ofron Shqipëria edhe me kompani të tjera me të cilat kanë bashkëpunim.



## EEN Albania përmbyll me sukses ciklin 2022–2025 dhe prezanton vizionin për fazën e re 2025–2028

Në Tiranë, 25 Qershor 2025 në një atmosferë dinamike e bashkëpunuese, rrjeti Enterprise Europe Network Albania, i koordinuar nga AIDA, mbylli fazën trevjeçare të projektit duke ndarë rezultatet, sfidat dhe rrugëtimin drejt së ardhmes së NVM-ve shqiptare.

– Kristi Qorri (AIDA), si menaxhere e projektit, prezantoi arritjet e EEN Albania (2022 – 2025), si edhe impaktin dhe objektivat e fazës së re, duke theksuar rritjen e aksesit në shërbime të personalizuar për sipërmarrjen shqiptare.

– Alida Kondi (CCP) – foli për sfidat e implementimit, fleksibilitetin dhe rolin kyç të bashkëpunimit ndërinstitucional për të mbështetur bizneset në faza kritike.

– Emila Raja (CCIDR) – nënvizoi se projekti ofroi mbështetje konkrete për sipërmarrjet lokale, në veçanti në ndihmën për përgatitjen për tregjet e BE-së.

– Sabi Osmani (WECA) – solli shembuj të drejtpërdrejtë të shërbimeve që WECA ka ofruar, nga mentorimi deri te lidhja me partnerë të huaj, me impakt të matshëm.

– Ilir Rembeci (ARZH) – vlerësoi rëndësinë e shtrirjes rajonale dhe përfshirjes së aktorëve vendorë në fuqizimin e rrjetit EEN në terren.

– Përveç partnerëve të konsorciumit, i pranishëm në event ishte edhe Ahmet Jetullahu (EEN Kosova / Prishtina REA) – theksoi vlerën e bashkëpunimit ndërkufitar dhe sinergjitë rajonale në nxitjen e inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Në përfundim të takimit, pjesëmarrësit patën mundësi të angazhohen në sesionin e rrjetëzimit dhe diskutimeve mbi objektivat e ardhshëm të projektit EEN Albania 2025–2028, i cili do të fokusohet në qëndrueshmëri, konkurrueshmëri, shërbime të personalizuar dhe integrim rajonal.



## Takim me përfaqësues të Ministrisë së Investimeve të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe kompanisë ADQ

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) pati kënaqësinë të mirëpriste në një takim përfaqësues të Ministrisë së Investimeve të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe kompanisë ADQ, një investitor lider në infrastrukturën globale kritike dhe zinxhirin e furnizimit.

Që nga themelimi i saj në vitin 2018, ADQ është shfaqur si një investitor sovran aktiv, duke ndërtuar dhe zgjeruar platforma biznesi të përqendruara në infrastrukturën kritike dhe zinxhirët globalë të furnizimit. Si një partner i Qeverisë së Abu Dhabit, ADQ krijon të ardhura të qëndrueshme financiare për Emiratet, ndërkohë që ofron edhe një ndikim pozitiv.

Gjatë këtij takimi, z. Ryan Freeman, bëri një prezantim të kompanisë e cila nisi si një kompani holding, duke kaluar nga niveli strategjik në nivel tregtar me më shumë se 130 asete në portofolin e projekteve. Subjekti shprehu interesin për të investuar në Shqipëri në sektorin mineral, specifikisht në përpunimin e nikelit, duke e konsideruar vendin tonë si një destinacion mjaft tërheqës për investitorët e huaj.



## AIDA – Takim me përfaqësues të organizatës International Labour Organization (ILO)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mirëpriti në një takim përfaqësuesit e organizatës International Labour Organization (ILO) lidhur me prezantimin e projektit Sustaining Competitive and Responsible Enterprises (SCORE).

Misioni i këtij takimi me znj. Laura Saro, Drejtore Ekzekutive e AIDA-s, ishte për të diskutuar potencialin e institucionalizimit të programit SCORE dhe ofrimin e trajnimit për stafin e tij si një mjet për të ndërtuar kapacitete dhe për të siguruar qëndrueshmëri.

Gjatë këtij takimi, znj. Rania Bikhazi, Specialist i Lartë nga ILO, prezantoj benefitet për bizneset nga programi SCORE që ndihmon NVM-të të aplikojnë praktikat më të mira ndërkombëtare dhe të integrohen në zinxhirët globalë të furnizimit.

AIDA shprehu gatishmërinë për të ofruar mbështetje të mëtejshme që mund të kontribuojnë në realizimin e këtij projekti.



## AIDA ju prezanton me thirrjen më të re të publikuar: “Women TechEU”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Programi synon startup-e në fazë të hershme, të udhëhequra nga gra në fushën e deep tech në vendet e BE-së dhe ato të asociuara me Horizon Europe.

Çfarë ofrohet:

- Grant prej €75,000 pa ndarje aksionesh
- Program 6-mujor mentorimi dhe zhvillimi biznesi
- Mbështetje për strategjinë e pronësisë intelektuale, hyrjen në treg dhe rritjen
- Qasje direkte në ekosistemin evropian të inovacionit

Vetëm 40 startup-e do të përzgjidhen  
Afati i fundit për aplikim: 4 Gusht 2025  
Apliko në: [www.womentecheuropa.eu](http://www.womentecheuropa.eu)

Në portalin “Akses në Financë” mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: Women TechEU

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitioni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/women-tech-eu-open-call-4>



## AIDA ju fton të merrni pjesë në panairin Future2Tech 2025

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka kënaqësinë t'ju ftojë në panairin Future2Tech 2025, që do të zhvillohet më 2-3 Tetor 2025, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

Future2Tech është ngjarja më e madhe rajonale e dedikuar teknologjisë, inovacionit dhe arsimit, duke ofruar një platformë unike për:

- Promovim të produkteve dhe shërbimeve tuaja përpara një audience profesionale.
- Rrjetëzim me aktorë kyç të industrisë: startupë, investitorë, institucione arsimore dhe politikëbërës.
- Bashkëpunime ndërkufitare, përmes aktiviteteve interaktive dhe zonave të specializuara.

Bashkohuni me ne për të formësuar të ardhmen, sot!

Për më shumë informacion dhe për të aplikuar për pjesëmarrje, ju lutemi kontaktoni organizatorët:

Web: [www.future2tech.al](http://www.future2tech.al)

Adresa: Rr. Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Nd. 32, H26 (6), Tiranë, Shqipëri, 1001

Email: [info@icebergexhibitions.com](mailto:info@icebergexhibitions.com)

Tel: +355 69 40 63 909



## AIDA ju fton të merrni pjesë në Panairin e Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së Gjelbër 2025

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka kënaqësinë t'ju ftojë të merrni pjesë në Panairin e Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së Gjelbër 2025, i cili do të mbahet më 29-30 Tetor 2025, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

Ky panair është ngjarja më e rëndësishme kombëtare dhe rajonale që bashkon dy sektorë strategjikë – energjinë dhe ndërtimin – në një platformë të vetme, me fokus në:

Pse të merrni pjesë?

- Promovoni kompaninë, produktet dhe zgjidhjet tuaja përpara një audience të specializuar dhe të targetuar.
- Zhvilloni kontakte dhe bashkëpunime strategjike me aktorë të industrisë.

Përfitoni nga një ekspozitë e mirëstrukturuar, me fokus në sektorët:

- Energji të rinovueshme (diellore, erë, bioenergji, hidroenergji etj.).
- Ndërtim i qëndrueshëm dhe ndërtesa të mençura (smart building).
- Teknologji të avancuara dhe mobilitet elektrik.

Angazhohuni në forume tematike, zona inovacioni, konkurse dhe workshop-e me përfaqësues nga qeveria, industria dhe akademja.

Për më shumë informacion dhe pjesëmarrje, ju lutemi kontaktoni organizatorët:

Email: [arben.oshafi@icebergexhibitions.com](mailto:arben.oshafi@icebergexhibitions.com)

[info@icebergexhibitions.com](mailto:info@icebergexhibitions.com)

Tel: +355 69 40 63 909

Web: [www.icebergexhibitions.com](http://www.icebergexhibitions.com)

